



Bazuar në nenin 58, pika (m), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregulloren për ndarje të Subvencioneve Nr. 01/24729, datë: 12.08.2015, të Komunës së Deçanit dhe neni 56, pika 16, të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës bënë:

Thirrje Publike

(Subvencionim të OJQ-ve dhe Klubeve Sportive)

Komuna e Deçanit, bënë thirrje publike të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Deçanit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në aktivitetet kulturore dhe sportive të Komunës së Deçanit.

Përparësi kanë aktivitetet si:

1. Festivali "Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen";
2. 5 dhe 6 Maj "Ditët e Dëshmorëve të Komunës së Deçanit";
3. Dita e Çlirimit;
4. Panairi Veror;
5. Panairi i Gështenjës.

Përparësi kanë OJQ-të që kanë përvojë në organizimin e aktiviteteve të cekura.

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 80,000.00 (tetëdhjetëmijë) euro.

Kriteret për aplikim:

- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, së paku 1 (një) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë.
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.
- Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të bashkangjitur në thirrje.

- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: Ndërtesa e Komunës së Deçanit, rruga "Jashar Salihu", Nr. 3, kati përdhese, në Zyrën Pritëse.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
- Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune duke filluar nga data: 25.04.2025 deri me 16.05.2025.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së;
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (obligative);
3. Certifikatën e regjistrimit (obligative);
4. Vërtetim nga ATK, që OJQ nuk ka obligime tatimore (obligative) dhe
5. Dëshmi e organizimit të aktiviteteve të ngjashme.

Kryetari i Komunës:

Bashkim Ramosaj



 DECAN - DECANI - DECAN REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DECANIT - DECANI - DECAN	
Nr. i dokumentit Org. i dokumentit Org. i dokumentit	Z. KRYETARIN 02 25.04.25
Nr. i dokumentit Org. i dokumentit Org. i dokumentit	